



# QKMF “DR. SHPËTIM ROBAJ” MALISHEVË

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA
QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
MAIN FAMILY MEDICAL CENTRE
“Dr. SHPËTIM ROBAJ”
MALISHEVË
Nr. 367
Data: 05/04/2023

## RAPORT PUNE

PËR DREJTORINË E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE - MALISHEVË

PROJEKTI I VIZITAVE SISTEMATIKE TË NXËNËSVE TË SHKOLLAVE  
FILLORE TË MESME TË ULTA (KLASA E PARË (I), KLASA E PESTË (V)  
DHE KLASA E NËNTË (IX))

Përgatitur nga: Dr. Ali Krasniqi, Sp. i Biokimisë Klinike – Koordinator i Cilësisë

Dr. Gëzim Krasniqi, Sp. i Pediatrisë

Drejtori i QKMF-së:

Dr. Afrim Krasniqi, Sp. i Mjekësisë Familjare

Malishevë, 04.04.2023

## PËRMBAJTJA

<b>HYRJE .....</b>	3
<b>QËLLIMI .....</b>	3
<b>OBJEKTIVAT .....</b>	3
<b>PLANIFIKIMI I PROJEKSTIT TË VIZITAVE SISTEMATIKE .....</b>	4
<b>METODOLOGJIA E PUNËS .....</b>	4
Materiali dhe mjetet e punës .....	5
Ekipet implementuese .....	5
<b>REZULTATET .....</b>	5
<b>I.REZULTATET E EKZAMINIMIT MJEKËSOR .....</b>	6
RRITJA DHE ZHVILLIMI .....	6
HIGJIENA PERSONALE .....	6
LËKURA .....	7
TË PAMURIT .....	7
TË DËGJUARIT .....	7
KAFAZI I KRAHËRORIT .....	7
BOSHTI KURRIZOR .....	8
EKSTREMITETET .....	8
SISTEMI I FRYMËMARRJES .....	8
STATUSI PSIKIK .....	8
REFERIMET .....	8
<b>II.REZULTATET E EKZAMINIMIT STOMATOLOGJIK .....</b>	8
HIGJIENA ORALE .....	8
DENTICIONI PRIMAR .....	8
DENTICIONI I PËRHershëM .....	9
INDEKSI I HIGJENËS ORALE (OHI) .....	9
REFERIMET .....	9
<b>PËRFUNDIMI .....</b>	9
<b>REKOMANDIMET .....</b>	11
Shtojca 1 Formulari i përdorur për realizimin e vizitave sistematike .....	12
Shtojca 2 Përbledha e aktiviteteve për realizimin e projektit të vizitave sistematike dhe personeli i angazhuar .....	14

## **HYRJE**

Shëndeti i fëmijëve në procesin e rritjes dhe zhvillimit, është një tregues i rëndësishëm për gjendjen shëndetësore të popullatës. Në mënyrë që rritja dhe zhvillimi i tyre të jetë sa më i mirë kërkohet një kujdes i veçantë shëndetësor.

Në shkollat fillore të Komunën e Malishevës nuk ofrohen shërbimet shëndetësore, kështu që nuk mund të bëhet përcjellja e vazhdueshme e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve. Për këtë arsyе Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Malishevë në bashkëpunim me stafin udhëheqës të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Shpëtim Robaj” morën iniciativën për organizimin e vizitave sistematike të nxënësve të Shkollave Fillore të Mesme të Ulta në Komunën e Malishevës, ku do të bëhet vlerësimi i gjendjes shëndetësore të nxënësve, identifikimi i deformiteteve, anomalive apo sëmundjeve specifike për moshën dhe ndërmarrjen e masave për parandalim dhe korrigjimin e tyre.

## **QËLLIMI**

Qëllimet e projektit të vizitave sistematike janë:

- Vlerësimi i rritjes dhe zhvillimit psiko-fizik të fëmijëve të grupmoshave të klasave të para (I), të pesta (V) dhe të nënta (IX) të Shkollave Fillore të Mesme të Ulta të Komunës së Malishevës.
- Zbulimi i hershëm i sëmundjeve, anomalive dhe çrregullimeve eventuale të fëmijëve të këtyre grupmoshave me qëllim të ndërmarrjes së masave.

## **OBJEKTIVAT**

- Identifikimi i problemeve më të shpeshta shëndetësore apo ngecjeve në zhvillimin fizik dhe psikik të tyre.
- Krijimi i një baze të të dhënave për gjendjen shëndetësore të këtyre grupmoshave dhe ndërmarrjen e masave për ndërhyrjet dhe përmirësimet eventuale.
- Krijimi i një pasqyrë të përgjithshme për gjendjen shëndetësore të nxënësve dhe përcjellja në vazhdimësi.

## **PLANIFIKIMI I PROJEKTIT TË VIZITAVE SISTEMATIKE**

Drejtori i QKMF-së fillimisht prezantoi idenë e realizimit të projektit të vizitave sistematike para kolegjiumit tw shefave të shërbimeve. Pas dakordimit nga të gjithë që ky projekt të realizohet u diskutua rreth mundësive dhe mënyrave për realizimin e tij.

Pasi që nuk ekziston mundësia që të sigurohet programi elektronik u vendos që vizitat të realizohen duke plotësuar formularët me dorë. Andaj u hartua formulari për realizimin e vizitave sistematike, i cili përbëhet pre dy pjesëve pjesa e parë për ekzaminim mjekësor dhe e dyta për ekzaminim stomatologjik.

Hartimi i formularëve për pjesën mjekësore u realizua në konsultim me shërbimin pediatrik dhe shërbimin e mjekësisë familjare, ndërsa për pjesën e shëndetit oral u konsultua shërbimi i shëndetit oral.

Grupi punues u pajtua që evidentimi i të dhënave të bëhet në këta formularë e pastaj të dhënat të regjistrohen në databazë.

Plani i punës dhe orari i projektit të vizitave sistematike u hartuan në bazë të numrit të shkollave dhe numrit të nxënësve. Në bazë të të dhënave të siguruara nga Drejtoria e Arsimit në 37 Shkollat e Mesme të Ulta të Komunës së Malishevës në klasat I, V dhe IX ishin të regjistruar 2544 nxënës. Nga Drejtoria e Arsimit siguruam edhe të dhënat për kontakt të drejtoreve të shkollave, për njoftimin paraprak për orarin e vizitave në shkolla, në mënyrë që të sigurohen kushtet dhe hapësirat për realizimin e këtyre vizitave.

## **METODOLOGJIA E PUNËS**

Për realizimin e këtij projekti u zhvilluan vizita mjekësore dhe sotmatologjike te nxënësit, si vend për vizitë u caktua njëra nga klasat e shkollës.

Gjatë ekzaminimit mjekësor të gjeturat u regjistruan në formularin përkatës në faqen e parë të paraparë për ekzaminimin mjekësor. Ndërsa të gjeturat nga vizita stomatologjike u shënuan në faqen e dytë të formularit të paraparë për vizitë sotomatologjike.

Faqja e parë e formularit e dedikuar për Ekzaminim mjekësor, fillimisht duhej plotësuar të dhënat personale, pastaj nxënësit i matej pesha dhe gjatësia. Për të vazhduar me vlerësimin e higjienës personale, praninë e pedikulozës së kokës, ekzaminimin e lëkurës, të pamurit, të dëgjuarit, ekzaminimin e kafazit të kraharorit, boshtit kurrizor, ekstremiteteve, sistemit kardiovaskular (SKV), sistemit nervor qendror (SNQ), statusin psikik dhe referimin eventual pwr konsultim.

Faqja e dytë e fomularit është e dedikuar për vlerësim të shëndetit oral. Në këtë faqe stomatologu duhet të vlerësoj higjienën orale, statusin dental të dhëmbëve primar dhe të dhëmbëve të përhershëm, përcaktimin e indeksit të higjienës orale (OHI), si dhe referimin.

Të dhënat e shënuara në formularë për secilin nxënës të përfshirë në vizita u grumbulluan në databaza të Excel, ku formuan tabelat me të dhëna për secilën shkollë sipas regjisitrave të nxënësve.

Pas grumbullimit të të gjitha të dhënavë u bë përpunimi i tyre dhe u nxorën rezultatet.

### **Materiali dhe mjetet e punës**

Autoambulanca për transportin e ekipës mjekësore

Çanta e mjekut

Tabela e Snellenit

Peshorja

Metri

Pasqyrat stomatologjike

Formularët, etj.

### **Ekipet implementuese**

Ekipa mjekësore përbëhej nga: një mjek familjar, pesë infermierë, një doktor i stomatologjisë, një asistent i stomatologjisë.

Gjithsej personel i angazhuar në projektin për realizimin e vizitave sistematike ishte 32.

## **REZULTATET**

Vizitat sistematike kanë filluar më 22.11.2022 në SHFMU “Ruzhdi Xhyliçi” në Marali dhe kanë përfunduar më 15.12.2022 me vizitat në SHFMU “Ibrahim Mazreku” në Malishevë.

### **Përfshirja e nxënësve në vizitat sistematike**

Në bazë të të dhënavë të marrura nga Drejtoria e Arsimit të planifikuar për vizita sistematike ishin 2544 nxënës ndërsa u vizituan 2366 nxënës apo 93% të nxënësve.

Duhet theksuar se ekipet mjekësore nuk u lejuan të kryejnë vizita në SHFMU “Imer Krasniqi” në Carrallukë në klasën e IX e cila kishte 22 nxënës. Kjo ndodhi pasi që nuk lejoi mësuesi kujdestar i klasës.

Gjatë ekzaminimit sotomatologjik 3 nxënës refuzuan vizitën.

## Raporti gjinor

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve të përfshirë në vizita sistematike 1174 apo 49.62% ishin vajza dhe 1192 apo 50.38% ishin djem.

## I.REZULTATET E EKZAMINIMIT MJEKËSOR

### RRITJA DHE ZHVILLIMI

#### Pesha mesatare e nxënësve të ekzaminuar

Rezultatet e vizitave sistematike treguan se pesha mesatare te nxënësit e klasëve të para ishte 22.45 kg, te nxënësit e klasëve të pesta 36.23 kg dhe te nxënësit e klasëve të nënta 53.7 kg.

#### Gjatësia mesatare

Gjatësia mesatare te nxënësit të klasëve të para ishte 118 cm, te nxënësit e klasëve të pesta 141 cm dhe të ata të klasëve të nënta 163 cm.

#### Indeksi i Masës Trupore (IMT) – Body Bass Index (BMI)

Paraqet raportin në mes të peshës dhe gjatësisë dhe përdoret si një tregues i përgjithshëm nëse një person ka një peshë trupore normale sipas moshës së tij. Për llogaritjen e këtij indeksi kemi përdorur kalkulatorin nga interneti. (<https://www.calculator.net/bmi-calculator.html>)

Sipas Qendrës për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) varësisht nga rezultati i IMT fëmijët dhe adoleshëntët prej 2 deri në 20 vjet karakterizohen në këtë mënyrë: nënpeshë, peshë normale, rrezik për mbipeshë dhe mbipeshë.

Rezultatet treguan se nga numri i përgjithshëm prej 2366 nxënësve të ekzaminuar, 107 ishin nën peshë, 1736 me peshë normale, 309 ishin me rrezik për mbipeshë dhe 214 në mbipeshë.

Kategorizimi i nxënësve sipas indeksit të masës trupore		
Kategorizimi	Nr i nxënësve	Përqindja
Nënpeshë	107	4.52%
Peshë normale	1736	73.37%
Rrezik për mbipeshë	309	13.06%
Mbipeshë	214	9.04%

## HIGJIENA PERSONALE

### 1.Niveli i higjenës

Për përcaktimin e nivelit të higjenës personale kemi përdorur poentimin me pesë nivele të higjenës: dobët (1), mjaftueshëm (2), mirë (3), shumë mirë (4) dhe shkëlqyeshëm (5).

Rezultatet e ekzaminimit gjatë vizitës sistematike treguan se nivel të dobët kishte të 3 nxënës, nivel të mjaftueshëm 35 nxënës, nivel të mirë te 91 nxënës, nivel shumë të mrië 481 nxënës ndërsa nivel të shkëlqyeshëm te 17756 nxënës.

#### Vlerësimi i nivelit të higjenës së nxënësve

Nivel i higjenës	Numri i nxënësve	Përqindja
I dobët	3	0.13%
I mjaftueshëm	35	1.47%
I mirë	91	3.84%
Shumë i mirë	481	20.33%
I shkëlqyeshëm	1756	74.22%

#### 2. Pedikuloza

Nga 2366 nxënës të ekzaminuar prania e morrave të kokës u vërejt në 80 nxënës apo 3.38%. Ndërsa sipas klasave në klasët e IX u identifikuani 42 raste apo 52.5%, në klasat e V 28 raste apo 35.0% dhe në klasat e I u identifikuani 10 raste apo 12.5%.

#### LËKURA

Gjatë ekzaminimit të lëkurës te fëmijët e përfshirë në vizita sistematike janë evidentuar 127 nxënës me ndryshime lëkuore. Ndryshimet janë si në vijim: 47 me Efelide, 27 me akne, 10 me Dermatomycosis, 8 me Verruca Vulgaris, 4 me Vitiligo, 3 me Scabies, 3 me Urticarie, 2 me Ekzema, 2 me Herpes, një me Ichthyosis vulgaris, një me Nishan, një me Combustio, dhe 20 të tjera.

#### TË PAMURIT

Rezultatet tona treguan se prej 2366 nxënësve të ekzaminuar, 206 nxënës apo 8.7% kishin probleme në shikim. Ndërsa sipas diagnozave u identifikuani 54 raste me Ambliopi, 51 me miopi, 8 me hipermetropi dhe 93 nxënës që mbanin syze.

#### TË DËGJUARIT

Gjatë ekzminimeve mjekësore u identifikuua vetëm një rast me dëgjim të dobësuar.

#### KAFAZI I KRAHËRORIT

Nga 2366 nxënës të vizituar 58 prej tyre patën crregullime të kafazit të krahërorit, ku 40 prej tyre Pectus Carinatus, ndërsa 18 prej tyre Pectus Excavatus.

## BOSHTI KURRIZOR

Nga 2366 nxënës të vizituar në 5 prej tyre u vërejtën crregullim të boshtit kurrizor dhe të gjitha rastet ishin me skoliozë.

## EKSTREMITETET

Nga 2366 nxënës të vizituar vetëm te 2 prej tyre u vërejtën ndryshime në ekstremitete.

## SISTEMI I FRYMËMARRJES

Nga 2366 nxënës të vizituar ndryshime të sistemit të frysëmarrjes u vërejtën te 228 nxënës.

Ndërsa sëmundjet më të shpeshta ishin Hipertorfia e tonsillave me 97 raste, Angina 58, Tonsilliti 35, bronhit 27, Bronkopneumonia 5, Astma 2, Tonsilofarinigiti 2, Faringiti 1, dhe kollitje 1.

## STATUSI PSIKIK

Vizitat sistematike evidentuan 14 nxënës me ndryshime të statusit psikik. Te 11 nxënës statusi psikik nuk i përgjigjej moshës, 2 raste me Autizëm dhe 1 me ngecje në zhvillim.

## REFERIMET

Gjatë vizitave sistematike mjekët dhanë 349 udhëzime për trajtim të mëtejshëm te specialistët përkatës. Kështu numri më i madh i referimeve ishte për te Pediatri 93 raste, Oftalmologu 85 raste, Mjeku Familjar 68 raste, ORL 34, Dermatologu 25, Ortopedi 18, Laborator 9 raste, Logopedi 6, Psikologu 5 dhe te të tjera 6 raste.

## II.REZULTATET E EKZAMINIMIT STOMATOLOGJIK

### HIGJIENA ORALE

Prej 2363 nxënësve të vizituar higjiena orale e kënaqshme ka qenë te 1625 apo 68.77% prej tyre, ndërsa higjiena orale jo e kënaqshme te 738 apo 31.23% prej tyre

### DENTICIONI PRIMAR

Nga 2363 nxënës të vizituar 2043 apo 86.46 % prej tyre kanë pasur ndryshime të dhëmbëve primar. Te numri më i madh i nxënësve janë evidentuar dhëmbë me karies me gjithsej 1287 apo 54.46% nga numri i përgjithshëm i të vizituarve. Te 469 nxënës apo 19.85% është hasur Radix relicta, te 258 nxënës apo 10.92% prej tyre është vërejtur mungesë e dhëmbëve. Te 12 nxënës janë vërejtur dhëmbë të mbushur pa karies, ndërsa te 6 nxënës ka pasur dhëmbë të mbushur me karies. Te 5 nxënës janë vërejtur traum-fraktura të dhëmbëve. Te 3 nxënës janë vërejtur anomali ortodontike, ndërsa po ashtu te 3 nxënës janë vërejtur dhëmbë në dalje.

## DENTICIONI I PËRHershëM

Nga numri i përgjithshëm prej 2363 nxënës të vizituar te 2025 apo 85.69% prej tyre janë vërjetur çrrregullime të dhëmbëve të përhershëm. Te numri më i madh i nxënësve 1403 apo 59.37% prej numrit të përgjithshëm janë vërejtur dhëmbë me karies. Te 211 nxënës janë vërejtur dhëmbë të mbushur pa karies ndërsa te 120 dhëmbë të mbushur me karies. Te 140 nxënës kemi hasur Radix relictia. Te 117 nxënës është vërejtur mungesë e dhëmbëve, ndërsa te 16 prej tyre dhëmbët mungojnë për arsyet tjetra. Te 18 nxënës janë vërejtur Trauma-frakturna të dhëmbëve. Ndërsa te 120 prej tyre janë vërejtur anomali ortodontike.

## INDEKSI I HIGJENËS ORALE (OHI)

Në tabelën e mëshposhtme janë dhënë rezultatet e vlerësimit të higjenës orale. Ku shihet se te 169 nxënës nuk ka depozitime të buta, te 1601 nxënës depozitimet e buta mbulojnë 1/3 e sipërfaqes së dhëmbit, te 387 nxënës depozitimet e buta mbulojnë më shumë se 1/3 e më pak se 2/3 e sipërfaqes së dhëmbit dhe te 206 nxënës depozitimet e buta mbulojnë më shumë se 2/3 e sipërfaqes së dhëmbit.

Vlerësimi i Indeksi të higjenës orale (OHI)		
Indeksi i higjenës orale (OHI)	Nr i nxënësve	Vlera në %
Nuk ka depozitime të buta	169	7.15%
Depozitimet e buta mbulojnë 1/3 e sipërfaqes së dhëmbit	1601	67.75%
Depozitimet e buta mbulojnë më shumë se 1/3 e më pak se 2/3 e sipërfaqes së dhëmbit	387	16.37%
Depozitimet e buta mbulojnë më shumë se 2/3 e sipërfaqes së dhëmbit	206	8.71%
<b>Totali</b>	<b>2363</b>	<b>100%</b>

## REFERIMET

Nga 2363 nxënës të vizituar, 64 prej tyre janë referuar për ekzaminim të mëtejshëm, dhe atë 49 te stomatologu dhe 15 te ortodonti.

## PËRFUNDIMI

Gjatë periudhës 22.11.2022 deri më 20.12.2022 ekipet mjekësore nga QKMF “Dr. Shpëtim Robaj” në Malishevë kanë zhvilluar vizita sistematike të nxënësve të klasave I, V dhe IX, në të gjitha Shkollat e Mesme të Ulta të Komunës së Malishevës, përkatësisht në 37 shkolla.

Në vizita sistematike janë përfshirë 2366 nxënës apo 93% të nxënësve nga numri i nxënësve të planifikuar (2544 nxënës), munguan 178 nxënës apo 7%.

Bazuar në gjininë e nxënësve të vizituar, 1174 apo 49.62% ishin vajza dhe 1192 apo 50.38% ishin djem.

Sipas rezultateve nga vizitat mesatarja e peshës trupore tek nxënësit e klasave I ishte 22.45 kg, te nxënësit e klasëve të pesta 36.23 kg dhe te nxënësit e klasëve të nënta 53.7 kg.

Gjatësia mesatare te nxënësit të klasëve të para ishte 118 cm, te nxënësit e klasëve të pesta 141 cm dhe të ata të klasëve të nënëta 163 cm.

Pas llogaritjes së Indeksit të Masës Trupore (IMT), rezultatet treguan se 1736 nxënës apo 73.37% kishin peshë normale, 107 nxënës apo 4.52% ishin nën peshë, 309 nxënës apo 13.06% ishin me rrezik për mbipeshë dhe 214 apo 9.04% në mbipeshë. Pra dominojnë nxënësit në rrezik për mbipeshë dhe ata me mbipeshë krahasur me nxënësit në nënpeshë.

Gjatë përcaktimit të nivelit të higjienës rezultatet gjatë vizitës sistematike treguan se nivel të dobët kishte të 3 nxënës (0.13%), nivel të mjaftueshëm 35 nxënës (1.47%), nivel të mirë te 91 nxënës (3.84%), nivel shumë të mirë te 481 nxënës (20.33%) ndërsa nivel të shkëlqyeshëm te 17756 nxënës (74.22%).

Nga numri prej 2366 nxënësve të përfshirë në vizita sistematike, prania e morrave të kokës u vërejt në 80 nxënës apo 3.38%. Ndërsa sipas klasave në klasët e nënta (IX) u vërejtën 42 raste apo 52.5%, në klasat e pesta (V) 28 rastë apo 35.0% dhe në klasat e para (I) u vërejtën 10 raste apo 12.5%.

Gjatë ekzaminimit të lëkurës janë evidentuar 127 nxënës me ndryshime lëkurore. Ndryshimet janë si në vijmë 47 me Efelide, 27 me akne, 10 me dermatomycosis, 8 me Verruca Vulgaris, 4 me Vitiligo, 3 me Scabies, 3 me Urticarie, 2 me Ekzema, 2 me Herpes, një me Ichthyosis vulgaris, një me Nishan, një me Combustio, një me Ekzma tetani, një me Strie dhe 18 me të tjera.

Gjatë ekzaminimit të Pamurit janë identifikuar 54 nxënës me Ambliopi, 51 me Miopi, 8 me Hipermetropi dhe 93 nxënës që mbanin syze.

Prej të gjithë të vizituarve u identifikua vetëm një rast me dëgjim të dobësuar.

Gjatë ekzaminimit të kafazit të krahërорit, u identifikuan 40 nxënës me Pectus Carinatus dhe 18 nxënës me Pectus Excavatus.

Tek 5 nxënës u vërejtën ndryshime të boshtit kurrizor që të gjitha rastet ishin me skoliozë

Nga 2366 nxënës të vizituara te yetëm 2 prej tyre u vërejtën ndryshime në ekstremitetë.

Ndryshime të sistemit të frysëmarrjes u identifikuau te 228 nxënës. Kështu që 97 nxënës u identifikuau me Hipertorfë të tonsillave, 58 me Anginë, 35 me Tonsillit, 27 me Bronhit, 5 me Bronkopneumoni, 2 me Astma, 2 me Tonsilofarinigit, 1 me Faringit dhe 1 me kollitje.

Në bazë të rezultateve të fituara te 14 nxënës u vërejtën ndryshime të statusit psikik. Te 11 nxënës statusi psikik nuk i përgjigjej moshës, 2 raste me Autizëm dhe 1 rast me ngecje në zhvillim.

Sipas vlerësimit të higjenës orale, higjena orale ishte e kënaqshme te 1625 nxënës apo 68.77% dhe jo e kënaqshme te 738 nxënës apo 31.23%.

Nga 2363 nxënës të vizituar 2043 apo 86.46 % prej tyre kanë pasur ndryshime të dhëmbëve primar. Te 1287 nxënës janë evidentuar dhëmbë me karies. Te 469 nxënës është identifikuar Radix reicta, te 258 nxënës është vërejtur mungesë e dhëmbëve. Te 12 nxënës janë vërejtur dhëmbë të mbushur pa karies, ndërsa te 6 nxënës ka pasur dhëmbë të mbushur me karies. Te 5 nxënës janë vërejtur traumë-fraktura të dhëmbëve. Te 3 nxënës janë vërejtur anomali ortodontike, ndërsa po ashtu te 3 nxënës janë vërejtur dhëmbë në dalje.

Nga numri i përgjithshëm prej 2363 nxënës të vizituar te 2025 apo 85.69% prej tyre janë vërejtur ndryshime të dhëmbëve të përhershëm. Te 1403 nxënës janë vërejtur dhëmbë me karies. Te 211 nxënës janë vërejtur dhëmbë të mbushur pa karies ndërsa te 120 dhëmbë të mbushur me karies. te 140 nxënës kemi hasur Radix reicta. Te 117 nxënës është vërejtur mungesë e dhëmbëve, ndërsa te 16 prej tyre dhëmbët mungojnë për arsyet e tjerë. Te 18 nxënës janë vërejtur Trauma-fraktura të dhëmbëve. Anomali ortodontike janë vërejtur te 120 nxënës.

## **REKOMANDIMET**

Nga të gjeturat e vizitave sistematike japim rekomandimet tona për veprimet e mëtejme:

Edukimi i vazhdueshëm i nxënësve për mirëmbajtje të higjenës personale.

Edukim i nxënësve për të ushqyer të shëndetshëm dhe aktivitet të lira (fizike).

Nxënësit me probleme në të pamur të vizitohen rregullisht nga oftalmologu dhe të korrigohen në mënyrë të rregullt dhe sipas kritereve refrakcionit.

Nxënësit me status psikik që nuk i përgjigjen moshës dhe me autizëm duhet të kenë tretman të veçantë nga personeli arsimor si dhe përkujdesje të psikologut.

Edukimi shëndetësor për mirëmbajtje të higjenës orale.

Rekomandimi i nxënësve që të vizitohen rregullisht te stomatologu, në mënyrë që të përmirësohet kariesi i dhëmbëve, si dhe të bëhet korrigimi i anomalive ortodontike.

Krijimi i kushteve që të kryhen vizitat sistematike në vazhdimësi.

Aplikimi i programeve kompjuterike gjatë realizimit të vizitave sistematike në të ardhmen.

Shtojca 1 Formulari i përdorur për realizimin e vizitave sistematike



## QKMF "DR. SHPËTIM ROBAJ" MALISHEVË

### FORMULARI PËR VIZITË SISTEMATIKE TË NXËNËSIT

Shkolla \_\_\_\_\_ Klasa \_\_\_\_\_

Emri, Emri i prindit, Mbiemri \_\_\_\_\_ Ditëlindja: \_\_\_\_\_

Vendbanimi: \_\_\_\_\_ Kontakti: \_\_\_\_\_

Gjinia: M / F      Pesa: \_\_\_\_\_ kg.      Gjatësia: \_\_\_\_\_ cm.

Veset negative: a) pirja e duhanit, b) të tjera \_\_\_\_\_

#### EKZAMINIMI MJEKËSOR

1	Higjiena personale Pedikulozë	1 Po	2	3	4	5 Jo
2	Lëkura					
3	Të pamurit					
4	Të dëgjuarit					
5	Kafazi i kraharorit					
6	Boshti kurrizor					
7	Ekstremitetet					
8	SKV					
9	Sistemi respirator					
10	Abdomeni					
11	SNQ					
12	Statusi psikik					
13	Menstruacioni i parë					
14	Referimi					

Data e vizitës: \_\_\_\_\_

Mjeku: \_\_\_\_\_

## VLERËSIMI I SHËNDETI ORAL GJATË VIZITËS SISTEMATIKE

HIGIENA ORALE



## STATUSI DENTAL (DMTF - INDEKSI)

## Dhëmbët primar

- A** Të shëndoshë
  - B** Me karies
  - C** Të mbushur me karies
  - D** Të mbushur pa karies
  - E** Mungojnë-Ex
  - F** Dhëmbët në dalje
  - T** Trauma-fraktura
  - R** Radix reicta
  - O** Anomalitë ortodontike

## Dhëmbët e përhershëm

D	17	16	15	14	13	12	11	21	22	23	24	25	26	27	M
	47	46	45	44	43	42	41	31	32	33	34	35	36	37	

- |          |          |                            |
|----------|----------|----------------------------|
|          | <b>0</b> | Të shëndoshë               |
|          | <b>1</b> | Me karies                  |
|          | <b>2</b> | Të mbushur me karies       |
|          | <b>3</b> | Të mbushur pa karies       |
| <b>M</b> | <b>4</b> | Mungojnë-Ex                |
|          | <b>5</b> | Mungojnë për arsyet tjetra |
|          | <b>6</b> | Mbushja e fisurave-vulosja |
|          | <b>7</b> | Trauma-frakturna           |
|          | <b>8</b> | Radix relictia             |

INDEKSI I HIGIJENËS OBALË – OHI

16		11		26
46		31		36

- 0** Nuk ka depozitime të buta
  - 1** Depozitimet e buta mbulojnë  $\frac{1}{3}$  e sipërfaqes së dhëmbit
  - 2** Depozitimet e buta mbulojnë më shumë se  $\frac{1}{3}$  e më pak se  $\frac{2}{3}$  e sipërfaqes së dhëmbit
  - 3** Depozitimet e buta mbulojnë më shumë se  $\frac{2}{3}$  e sipërfaqes së dhëmbit

**Referimi:** \_\_\_\_\_

Data e vizitës: \_\_\_\_\_

## Stomatology:

Shtojca 2 Përbledhja e aktiviteteve për realizimin e projektit të vizitave sistematike dhe personeli i angazhuar

**Aktivitetet kryesore për realizimin e projektit të vizitave sistematike:**

- 1.Ideja, diskutimi, krijimi i grupit punues: Drejtori i QKMF-së: Dr. Afrim Krasniqi
- 2.Përpilimi i formularit për realizimin e vizitave, i ndarë në dy pjesë:
  - a)Ekzaminimi mjekësor: Dr. Gëzim Krasniqi, Dr. Ali Krasniqi, Dr. Afrim Krasniqi, Dr. Hetem Elshani
  - b)Ekzaminimi stomatologjik: Dr. Bajram Krasniqi, Dr. Sabri Badallaj, Dr. Ilirjan Morina
- 3.Hartimi i planit për realizim dhe përpunimi i regjistrave të nxënësve të pranuar nga drejtoria e arsimit Dr. Ali Krasniqi
- 4.Krijimi i ekipeve mjekësore Drejtori Dr. Afrim Krasniqi, Kryeinfermieri Shpejtim Paçarizi
- 5.Printimi i formularëve dhe krijimi i dosjeve për secilën shkollë: Dr. Ali Krasniqi, Dr. Afrim Krasniqi
- 6.Regjistrimi i të dhënave në databazë: Dr. Ali Krasniqi dhe praktikantet: Xhemile Hajdari, Albesa Limaj, Florjetë Hoxha, Fitore Paçarizi, Diellza Zogaj dhe Agnesa Krasniqi.
- 7.Analizimi dhe përpunimi i të dhënave Dr. Ali Krasniqi, Dr. Gëzim Krasniqi
- 8.Përgatitja e raportit: Dr. Ali Krasniqi, Dr. Gëzim Krasniqi

**Personeli i angazhuar në ekipet mjekësore:**

Mjekët: Dr. Afrim Krasniqi, Dr. Blerat Cenaj, Dr. Ymrie Shala, Dr. Fisnik Dukolli, Dr. Arbërie Shala-Gashi, Dr. Genc Krasniqi.

Stomatologët: Dr. Sabri Badallaj, Dr. Bajram Krasniqi, Dr. Ilirjan Morina, Dr. Shpend Thaci, Dr. Shkumbin Kryeziu.

Infermierët: Valentinë Kryeziu, Elonë Morina, Pranvera Pacarizi, Majlinda Hoti, Rinore Krasniqi, Mimoza Sertolli, Lavdije Pacarizi-Hoti, Madonë Morina.

Asistentët e stomatologjisë: Arben Paçarizi, Burim Telaku, Erkand Zogaj.